



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 455 Akti

Nr. 414 Vendimi
Tiranë, më 7.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektoshi	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 5.7.2021 dhe 7.7.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Blerta Hamza**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerta Hamza, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Blerta Hamza është subjekt i rivlerësimit bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” (në vijim Komisioni) është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 21.12.2018, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Blerta Hamza.
5. Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 18.2.2020, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerta Hamza, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 6.2.2020, të KDZH-së.
6. Me shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.6.2021, KLP-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Blerta Hamza.
7. Me vendimin nr. 1, datë 24.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Blerta Hamza, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
8. Në datën 10.1.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije edhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Në po këtë datë subjekti deklaroi, nëpërmjet komunikimit elektronik, mospasjen e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

9. Me kërkesën e datës 27.1.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 27.1.2020, znj. Blerta Hamza kërkoj nga Komisioni të verifikojë kompetencën lëndore për të shqyrtuar e për të vendosur në lidhje me procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur se në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 8.10.2016, nuk ka qenë prokurore e emëruar (magjistrate), por prokurore në stazh aktiv (magjistrate candidate).

10. Lidhur me këtë kërkesë, trupi gjykues arsyeton se: (i) neni 179/b i Aneksit të Kushtetutës, në përcaktimin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, përfshin të gjithë prokurorët dhe kategoritë e tjera, pa bërë asnjë specifikim, ndarje në nënkategori apo dallim midis prokurorëve në detyrë dhe atyre jo në detyrë; (ii) ligji nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 17 përcakton se: “Emërohet prokuror në njërin nga prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, personi i cili ndër të tjerash ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës”. Në nenin 23 të po këtij ligji parashikohet se: “Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës emëron prokurorë në stazh personat që kanë mbaruar vitin e 2-të të Shkollës së Magjistraturës, për të kryer stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, ‘Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë në prokuroritë pranë gjykatave që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi. Pas përfundimit të stazhit profesional, Presidenti i Republikës dekreton caktimin e tyre në prokuroritë sipas nevojave që kanë këto të fundit”; (iii) në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij përcaktohet se: “Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga: ‘a) Një vit program teorik më lëndë të ndryshme të së drejtës; b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë; c) një vit praktik me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional)”. Po ashtu, ky ligj në nenin 19 të tij përcakton se: “Në përfundim të periudhës së parashikuar në germen ‘b’ të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magjistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm”; (iv) subjekti Blerta Hamza në vitet 2014 – 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës; (v) me anë të Dekretit Nr. 9219, datë 7.9.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, subjekti është emëruar prokurore në stazh aktiv (magjistrate candidate) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, për periudhën shtator 2015 - tetor 2016; (vi) me Dekretin Nr. 9756, datë 11.10.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është emëruar prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, funksion që ushtron edhe aktualisht; (vii) në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, në gusht të vitit 2016, znj. Blerta Hamza ka qenë prokurore në stazh. Stazhi si prokuror/e i/e përkohshëm/me, sipas ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, kryhet në vitin e 3-të të Shkollës së Magjistraturës dhe e vendos kandidatin në kushtet e ushtrimit të funksionit në detyrën e prokurorit, edhe pse me emërim të përkohshëm; (viii) ligji nr. 96/2016, në dispozitat e tij tranzitore, nenet 164 dhe 169 të tij, e lidh qëndrimin e subjekteve në detyrë me kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit.

Përveç sa më sipër, subjekti, në zbatim të detyrimeve si subjekt rivlerësimi *ex officio*, ka përmbushur detyrimet e cituara shkurtimisht në dispozitat e mëposhtme: (a) ka plotësuar deklaratën e pasurisë sipas pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda

30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së”; (b) ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës sipas pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se: *“Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”*; (c) ka plotësuar formularin e vetëvlerësimit profesional sipas pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se: *“Subjekti i rivlerësimit plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale”*.

Në përfundim, bazuar në më sipër, trupi gjykues vlerëson se znj. Blerta Hamza është subjekt rivlerësimi sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

11. Me vendimin nr. 2, datë 22.6.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Blerta Hamza dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi profesional, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

12. Në datën 22.6.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 29.6.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

13. Në datën 29.6.2021 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

14. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 30.6.2021, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore, duke e njoftuar subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 5.7.2021, ora 11.00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, si dhe duke i dhënë të drejtën e përfaqësimit nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor.

15. Në datën 5.7.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

A. VLERËSIMI I PASURISË

16. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza ka dorëzuar më 27.1.2017, në ILDKPKI deklaratën e pasurisë, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2015, me nr. indeksi 13386 dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

17. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Blerta Hamza, ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e shtetasit F. H. (babai i subjektit);
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit Blerta Hamza, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

19. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Blerta Hamza, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

20. Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

21. Llogari bankare page në “Raiffeisen Bank”, gjendja në datën 27.1.2017 rezulton 40,000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga. Gjatë hetimit administrativ, “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2020, ka konfirmuar gjendjen e llogarisë në të cilën kalojnë pagat, sipas deklaratimit të subjektit.

22. Gjendje cash në shumën 1,200,000 lekë, jashtë sistemit bankar. Burimi i krijimit: (a) kursimi nga të ardhurat e pagës dhe dieta si specialist/inspektore pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në vitet 2009 – 2013; (b) të ardhura nga bursa e Shkollës së Magjistraturës në vitet 2014 – 2015; (c) të ardhura nga paga si prokurore në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec në vitet 2015 - 2016; (ç) të ardhura nga paga si prokurore pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në intervalin kohor 17.10.2016 - 31.12.2016.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

23. Nga verifikimi i deklarimeve periodike rezultoi se subjekti ka kryer deklarime në lidhje me likuiditetin *cash*, si vijon: (i) në DPFĐ-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën 800,000 lekë me burim kursimet e pagës dhe dieta si specialiste, inspektore pranë ZQRPP-së Tiranë për periudhën 3.6.2009 – 31.12.2013 dhe kursimet nga bursa e Shkollës së Magjistraturës në vitet 1.2.2014 – 30.9.2015; (ii) në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë ndryshim nga deklarimi i mëparshëm në lidhje me gjendjen *cash*; (iii) në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar shtesa në shumën 400,000 lekë, me burim kursime nga pagat mujore si prokurore në intervalin kohor 1.1.2016 – 31.12.2016. Në total, gjendja *cash* jashtë sistemit bankar është në shumën 1,200,000 lekë. Deklarimet e subjektit në DPV përputhen me deklaratën *Vetting*.

24. Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për të krijuar këtë gjendje likuiditeti *cash*, u verifikuan dokumentet shkresore, të cilat vërtetonin të ardhurat sipas burimeve të deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si vijojnë: (i) kursimet nga të ardhurat e pagës dhe dieta si specialiste/inspektore pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në vitet 2009 - 2013, kanë qenë në shumën 2,881,036 lekë, shumë në të cilën nuk janë përfshirë të ardhurat nga dietat; (ii) të ardhurat nga bursa e Shkollës së Magjistraturës për vitet 2014 - 2015, kanë qenë në shumën 1,100,988 lekë; (iii) të ardhurat nga paga si prokurore në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec në vitet 2015 - 2016, kanë qenë në vlerën 1,059,072 lekë; (iv) të ardhurat nga paga si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në intervalin kohor 17.10.2016 - 31.12.2016, kanë qenë në vlerën 249,444 lekë.

25. Me qëllim kryerjen e analizës financiare për të verifikuar mundësinë e krijimit të likuiditetit *cash* prej 1,200,000 lekësh, subjekti u pyet për përbërjen faktike të familjes, si dhe për mënyrën e përballimit të shpenzimeve të jetesës, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe në përgjigjet e datës 27.5.2021 deklaroi se familja e origjinës përbëhej nga 5 anëtarë në periudhën 2009 – shtator 2015, kohë kur është larguar nga Tirana për të kryer stazhin në Gjykatën e shkallës së parë Pogradec. Sa i takon mbulimit të shpenzimeve, subjekti deklaroi se nga viti 2015 e në vijim, i ka përballuar vetë shpenzimet e jetesës. Për këtë arsye, subjekti është analizuar bashkë me familjen e saj të origjinës deri në momentin e fillimit të detyrës në datën 14.9.2015 dhe pas kësaj date është analizuar më vete.

26. Për të vërtetuar të ardhurat për familjarët e saj, subjekti paraqiti dokumente¹ që vërtetojnë pagën e babait F. H. për periudhën 2004 – 2016; (ii) dokumente² që vërtetojnë pagën e motrës N. H. për periudhën prill 2013 – janar 2018; (iii) dokumente³ që vërtetojnë pagën e vëllait Gj. H. për periudhën gusht 2014 – prill 2019.

¹Shkresa e ISSH-së që vërteton punësimin e shtetasës M. H. në kooperativën bujqësore Leshnicë-Korçë në periudhën 1978 – 1989; shkresa nr. *** prot., datë 20.8.2019, e ISSH-së për periudhën prill 2004 – shtator 2009; shkresa nr.*** prot., datë 7.8.2019, nga Ministria e Mbrojtjes për periudhën nëntor 2009 – shtator 2011; shkresa nr. *** prot., datë 5.8.2019, e ISSH-së për periudhën janar 2015 - dhjetor 2018; shkresa nr. *** prot., datë 5.8.2019, të ISSH-së për pension të parakohshëm të babait; librezë pune; ekstrakte të lëvizjeve të llogarive bankare ku kalon paga e tij në “Raiffeisen Bank” për periudhën maj 2005 – korrik 2013; “Tirana Bank” nga shtator 2015 – dhjetor 2016; BKT-ja nga shkurt 2015 – dhjetor 2019.

²Shkresa nr. ***, datë 5.8.2019, e ISSH-së vërteton pagat e znj. N. H. për të cilat janë paguar sigurime shoqërore për periudhën prill 2013 – janar 2018; ekstrakte të lëvizjeve të llogarive bankare ku kalon paga e saj: “Intesa Sanpaolo Bank” maj 2013 – dhjetor 2019; BKT-ja nga mars 2014 – janar 2016.

³Shkresa nr. ***, datë 05.08.2019, e ISSH-së që vërteton pagat e z. Gj. H. për të cilat janë paguar sigurime shoqërore për periudhën gusht 2014 – prill 2019; ekstrakte të lëvizjeve bankare ku kalon paga e tij: “Raiffeisen Bank” për periudhën shtator 2014 - dhjetor 2016 dhe nga “Credins Bank” për periudhën nëntor 2016 – janar 2018.

27. Bazuar në të gjitha dokumentet si më sipër, nga Komisioni:

Së pari u verifikua mundësia financiare e subjektit dhe familjes së saj për të krijuar shumën *cash* 800,000 lekë nga viti 2009 kur subjekti ka filluar të gjenerojë të ardhura dhe deri në datën 14.9.2015, që ka filluar detyrën, si në tabelën vijuese.

Familja e origjinës e subjektit	Periudha 2009 - 14.9.2015
Pasuritë	4 503 156
Apartament i paguar sipas kontratës datë 25.7.2015	2 800 000
Kursime ndër vite të krijuara nga subjekti	800 000
<i>Shtesa /pakësime/likuiditete</i>	303 156
Të ardhurat	13 361 787
Paga <i>neto</i> e babait	1 334 127
Pensioni i parakohshëm i babait F. H.	667 021
Paga <i>neto</i> e nënës M. H.	1 118 542
Paga e subjektit	4 038 195
Paga e motrës N. H.	351 720
Paga e vëllait Gj. H.	308 000
Kredi nga NBG-ja	600 000
Përfiturar nga shitja e pronës	3 779 000
Kredi nga “Raiffeisen Bank” disb.14.7.2015	850 000
Përfiturar nga interesat bankare	315 182
Shpenzimet	7 781 619
Shpenzimet e jetesës për 5 persona	5 347 869
Shpenzime qiraje	1 185 000
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	492 619
Shpenzime kredie	46 000
Paguar kredia në NBG	658 381
Paguar kredia në “Raiffeisen Bank”	28 400
Paguar për <i>overdraft</i> -in në vonesë, te Tranzit	23 350
Mundësia për kursime	1 077 013

Së dyti u verifikua mundësia financiare me të ardhura të ligjshme të subjektit për të shtuar kursimet *cash* në shumën 400,000 lekë gjatë vitit 2016, si në tabelën vijuese.

	Viti 2016
Përshkrimi	
Pasuritë	307 955
Kursime <i>cash</i>	400 000
<i>Shtesa/pakësime/likuiditetesh në banka</i>	-92 045
Të ardhurat	1 076 337
Të ardhura nga paga e subjektit	1 076 337
Shpenzimet	481 975
Shpenzime jetese për subjektin/1 person	136 620
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	175 725
Shpenzime transporti	98 000

Shlyer kredia marrë për blerje në shoqërinë “Neptun” në vitin 2015	68 630
Paguar komisione në bankë	3 000
Mundësia për kursime	286 407

Në përfundim, u vertetua se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të pasur gjendje likuiditeti *cash* në fund të vitit 2016 dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, shumën 1,200,000 lekë.

Në rubrikën detyrime financiare subjekti ka deklaruar:

28. Kartë krediti në “Raiffeisen Bank” me limit shumën 50,000 lekë, shuma e mbetur e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 40,899 lekë deri në datën 30.12.2016. Nga verifikimi i të dhënave bankare, shuma e detyrimit të pashlyer deri në datën 31.12.2016 është 50,330.82, lekë sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.1.2020, të “Raiffeisen Bank”. Të dhënat përputhen me deklaratimet e subjektit.

29. Kartë krediti në “Raiffeisen Bank” me limit shumën 500 euro, shuma e mbetur e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 389,13 euro deri në datën 30.12.2016. Nga verifikimi i të dhënave bankare, shuma e detyrimit të pashlyer deri në datën 31.12.2016 është 497,29 euro, sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.1.2020, të “Raiffeisen Bank”. Të dhënat përputhen me deklaratimet e subjektit.

30. Blerje elektroshtëpiake me këste për 12 muaj. Shlyerja në periudhën janar 2016 – dhjetor 2016. Detyrimi në total ka qenë në shumën 63,776 lekë dhe është shlyer pranë “Raiffeisen Bank”. Kësti mujor i mbajtur nga paga në vlerën 5.751,8 lekë/muaj. Shlyer plotësisht në dhjetor të vitit 2016. Këto të dhëna janë verifikuar me shkresën nr. *** prot., datë 4.1.2020, të “Raiffeisen Bank”. Të dhënat përputhen me deklaratimet e subjektit.

31. Kontratë qiraje apartamenti, lidhur më 15.1.2017 deri më 31.12.2017, me vlerë 10,000 lekë/muaj. Paguar paradhënie *cash* deri më 15.5.2017. Pavarësisht se afati i deklaruar i qirasë i përket periudhës pas deklaratës *Vetting*, nga shqyrtimi i akteve në dosjen e ILDKPKI-së⁴ dhe deklaratimeve të subjektit, Komisioni nuk evidentoi problematika në lidhje me pasurinë e deklaruar të marrë me qira, referuar fakteve si vijojnë:

- Kontrata e qirasë pa akt noterial e datës 15.1.2017, është lidhur midis qiradhënësit D. F. T. dhe qiramarrëses Blerta Hamza për afat 1-vjeçar në vlerën 10,000 lekë/muaj. Kjo kontratë ka si objekt apartament me sip. 55 m², pasuri nr. ***, në adresën: bulevardi “M. P. P.”, ap. ***, P., Shkodër. Ndërkohë, kjo adresë është deklaruar edhe si vendqëndrim tjetër në deklaratën *Vetting*. Pas kërkesës së Komisionit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, paraqiti kopje të certifikatës së pronësisë së pasurisë në emër të qiradhënësit D. F. T..

- Sipas “Aneks 1”, me mandatpagesën e datës 15.1.2017 vërtetohet pagesa e detyrimit të qirasë paradhënie për periudhën 15.1.2017-15.5.2017.

- Adresa e kësaj pasurie dhe marrja me qira është deklaruar nga subjekti edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 1. Nga dokumentet bashkëngjitur këtij pyetësori, rezultoi se: (i) kjo kontratë është rinovuar me të njëjtat kushte sipas kontratave që i përkasin datave 15.1.2018 dhe 15.1.2019; (ii) kontrata e fundit e datës 15.1.2019 është zgjidhur më 31.7.2019 sipas aktit “Deklarim për mbarim/zgjidhje kontrate qiraje”; (iii) subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet e qirasë për të gjithë kohëzgjatjen e qirasë dhe të gjitha detyrimet për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm.

⁴Shihni aktin në aneksin 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nuk rezultoi⁵ që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar çështje ku personi nën hetim të ketë qenë shtetasi D. F. T. dhe as procedime penale⁶ të regjistruara në emër të tij.

Konstatime të tjera

32. Në DPDF- në e vitit 2015 deri në deklaratën *Vetting*, është deklaruar si adresë e regjistrimit në gjendjen civile adresa: “Njësia Bashkiake Nr. 5, rr. ‘I. T.’, p. nr. ***, shk. nr. ***, ap. nr. ***, Tiranë”. Në DPV- në e vitit 2016 është sqaruar se kjo adresë është përdorur vetëm për efekt regjistrimi në gjendjen civile kur është transferuar në qytetin e Tiranës. Edhe në procesverbalin e ILDKPKI-së më 15.9.2016, subjekti ka sqaruar se kjo adresë është deklaruar prej saj për efekt regjistrimi në gjendjen civile, regjistrim i cili është bërë bazuar në një kontratë qiraje në emër të prindërve. Subjekti, e pyetur gjatë procesit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se në momentin e regjistrimit në gjendjen civile në Njësinë Bashkiake nr. 5, pasuria ka qenë në pronësi të shtetasve H., M. dhe B. A., përkatësisht halla e nënës, djali dhe bashkëshorti i saj, të cilët e kanë shitur në vitin 2017. Babai i saj ka lidhur një kontratë qiraje nr. ***, për pasurinë në bashkëpronësi të tyre, apartament me sip. 57 m², ndodhur në rrugën “I. T.”, për vlerën 15,000 lekë. Kjo kontratë ka shërbyer për regjistrimin e adresës së gjendjes civile në Njësinë Bashkiake Nr. 5. Subjekti ka vërtetuar plotësisht këto deklarime me aktet shkresore si vijojnë:

- kërkesë drejtuar ZGJC-së Njësia Bashkiake Nr. 5 Tiranë, shoqëruar me mandatpostar nr. ***, datë 29.4.2021;

- kontratë qiraje nr. ***, datë 6.7.2011;

- certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. ***, Tiranë, në emër të shtetasve H., M. dhe B. A.;

-kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 2.8.2017, midis familjes A. dhe palës blerëse F. B..

Nga analiza e dokumenteve të sipërpërmendura rezulton se adresa e gjendjes civile e deklaruar nga subjekti në DPDF- në e vitit 2015 deri në deklaratën *Vetting*, përputhet me adresën e pasurisë objekt i kontratës së qirasë së datës 6.7.2011 dhe se deklaratimet e subjektit janë të sakta.

33. Në DPDF-në e vitit 2015, DPV- në e vitit 2015 dhe në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar si adresë vendqëndrim tjetër adresën “Lagjja ‘U.’, rr. ‘T. K.’, p. I., nr. ***, ap. ***, k. ***, Bashkia Tiranë”, me sqarimin se në këtë banesë ka jetuar me familjen deri në dhjetor të vitit 2016, por nuk jeton më për shkak të ndryshimit të banesës nga prindërit. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka sqaruar se ka banuar përkohësisht në këtë banesë të përfutur prej babait të saj me kontratë për kalim të drejtash pronësie në periudhën shtator 2015 – tetor 2016, kur ka qenë prokurore në stazh aktiv në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

34. Duke qenë se subjekti ka deklaruar përdorimin e kësaj banese me qëllim evidentimin e ndonjë lidhjeje midis subjektit dhe kësaj pasurie, u kryen disa verifikime. Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga subjekti në pyetësorin standard nr. 1, rezultoi se:

⁵Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në dosjen e Komisionit.

⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit dhe shkresë, kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.6.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

34.1. Në datën 22.7.2015 është lidhur kontrata nr. ***, “për kalim të drejtash dhe detyrimesh”, mes palëve: pala e parë poseduesi A. C.; pala e dytë përfituese F. H. dhe pala e tretë sipërmarrësi dhe ndërtuesi i pasurisë si dhënë pëlqimi, shoqëria “I.’ sh.p.k., kontratë në të cilën pala e parë A. C. shpreh vullnetin që të kalojë në favor të palës së dytë F. H. të gjitha të drejtat e pronësisë që ka mbi apartamentin me sipërfaqe ndërtimi 91 m². Në lidhje me çmimin dhe mënyrën e likuidimit të tij kjo kontratë parashikon se çmimi në total prej 45,500 euro, do të paguhet nëpërmjet transfertave bankare nga z. F. H. në favor të znj. A. C., si vijojnë: (i) shuma 20,000 euro do të paguhet brenda datës 25.7.2015; dhe (ii) shuma 25,500 euro brenda muajit tetor të vitit 2016.

34.2. Sipas mandateve të paraqitura rezulton se: (i) me urdhërxhirim të brendshëm datë 22.7.2015, të “Credins Bank” është transferuar shuma 2,000,000 lekë nga llogaria e z. F. H. në llogarinë e znj. A. C.; (ii) me mandatarëtimin datë 24.7.2015 shuma prej 800,000 lekësh është derdhur në llogarinë e znj. A. C. nga znj. M. H. (nëna e subjektit). Në total shuma 2,800,000 lekë/20,000 euro është paguar nga prindërit e subjektit në llogari të znj. A. C. brenda datës 25.7.2015, sipas përcaktimeve të kontratës së sipërpërmendur.

34.3. Në datën 22.11.2016, palët F. H. dhe A. C. kanë nënshkruar aktin nr. ***, datë 22.11.2016, “Revokim kontrate” me anë të së cilës kanë rënë dakord: (i) për zgjidhjen e kontratës nr. ***, datë 22.7.2015 për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve; (ii) për kthimin e shumës së paguar në vlerën 2,800,000 lekë (kësti 1) në favor të z. F. H. nga znj. A. C., e cila do të kalojë po në këtë datë në llogarinë e z. F. H. në “Credins Bank”; (iii) se me kalimin e shumës në llogarinë e z. F. H., ai detyrohet të lirojë dhe dorëzojë apartamentin.

34.4. Kthimi i shumës prej 2,800,000 lekësh vërtetohet me: (i) urdhërxhirimin e brendshëm datë 22.11.2016, sipas të cilit ka kaluar në favor të z. F. H. shuma 1,900,000 lekë me përshkrimin “revokim kontrate nr. ***, nga znj. A. C.”; (ii) urdhërxhirimin e brendshëm datë 22.11.2016, sipas të cilit ka kaluar në favor të z. F. H. shuma 500,000 lekë me përshkrimin “revokim kontrate nr. ****”, me urdhërues z. N. Z.; (iii) urdhërxhirimin e brendshëm datë 24.11.2016 sipas të cilit ka kaluar në favor të z. F. H. shuma 400,000 lekë me përshkrimin “revokim kontrate nr. ****”, me urdhërues z. N. Z.. Veprimet e mësipërme janë konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2020, lëshuar nga “Credins Bank”, administruar në dosjen e Komisionit. Siç vërehet, znj. A. C. i ka kthyer z. F. H. shumën 2,800,000 lekë/20,000 euro.

35. Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar çështje ku persona nën hetim të kenë qenë shtetasit A. C. dhe S. C.⁷. Gjithashtu nuk rezultuan procedime penale për vepra të krimit të organizuar në ngarkim të tyre⁸, të regjistruara në emër të tyre. Në përfundim të hetimit administrativ nuk u evidentuan lidhje të subjektit me këtë pasuri, i cili në fakt, nuk ishte bërë ende subjekt deklarues në momentin e kryerjes së pagesës nga babai të shumës prej 2,800,000 lekësh në korrik të vitit 2015.

36. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar si vendqëndrim tjetër adresën “rr. ‘3 D.’, p. ****”, ap. nr. ***, k. ***, Njësia Administrative K., Tiranë”, adresë të cilën e ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 subjekti ka sqaruar se kjo adresë është ndryshuar nga organet shtetërore në vitin 2018 në: rr. “P. P.”, p. ***, h. ***, ap. ***, k. ***. Më tej, subjekti ka deklaruar se pronar i këtij objekti me kontratë kalim të drejtash

⁷Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në dosjen e Komisionit.

⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

pronësie, nga muaji nëntor 2016, është babai i saj F. H. dhe, për këtë arsye, ka banuar pa qira në këtë banesë për shkak të marrëdhënieve familjare.

37. E pyetur në lidhje me statusin juridik aktual të kësaj pasurie, në përgjigjet e datës 27.5.2021, subjekti ka informuar se nuk është bërë ende regjistrimi i kësaj prone në emër të babait pranë ZVRPP-së Tiranë, ndërkohë që ai ka bërë kërkesë zyrtare për hapjen e kartelës në emër të tij, pasi prona ndodhet ende në emër të investitorit “****” sh.p.k. Subjekti ka paraqitur kopje të librezës së ujit nga UKT-ja me kontratë nr. ***, zona ***, rruga “Y.” shk. ***, ap. ***, në emër të z. F. H., si dhe kopje të librezës së energjisë elektrike nga OSHEE-ja në emër të z. H. M. me kontratë nr. ***.

38. Duke qene se subjekti ka deklaruar përdorimin e kësaj banese me qëllim evidentimin e ndonjë lidhjeje midis subjektit dhe kësaj pasurie, u kryen disa verifikime. Konkretisht nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura bashkëngjitur pyetësorit nr. 1, konstatohet se:

38.1 Në datën 22.11.2016, në të njëjtën ditë me revokimin e kontratës së sipërtrajtuar është lidhur kontratë me nr. ***, për kalim të drejtash e detyrimesh mes palëve, z. M. L. në cilësinë e “poseduesit të të drejtave”, shtetas L. L., në cilësinë e “dhënëse pëlqimi”, si dhe z. F. H., në cilësinë e “përfituesit të të drejtave”. Kjo kontratë ka si objekt kalimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që pala poseduese (M. L.) ka mbi apartamentin nr. ***, me sip. 66 m², të drejta të fituara në bazë të kontratës së porosisë nr. ***, datë 9.10.2008⁹, të nënshkruar ndërmjet palës poseduese të të drejtave dhe shtetasit H. M., në cilësinë e pronarit të truallit. Sipas kontratës, ky kalim i të drejtave miratohet edhe nga znj. L. L., mbështetur në kushtet e përmendura në këtë kontratë dhe aktmarrëveshjen noteriale nr. ***, datë 17.10.2008¹⁰. Çmimi i shitjes së pasurisë është parashikuar në vlerën 26,000 euro, i cili do të paguhet nga pala përfituese e të drejtave, z. F. H., në llogarinë bankare të znj. L. L., pranë “Credins Bank” si vijon: (i) vlera 20,000 euro do të paguhet deri më 25.11.2016; dhe (ii) diferenca prej 6,000 euro deri më 10.1.2017. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.1.2017, shtetasja L. L. ka deklaruar se është paguar në total çmimi i blerjes në vlerën 26,000 euro.

38.2. Nga verifikimi i të dhënave bankare në “Credins Bank” u vërtetua që shuma prej 26,000 euro është likuiduar tërësisht nga z. F. H. si vijon: (i) me urdhërshkrimin datë 24.11.2016 është kaluar shuma prej 2,720,000 lekësh/20,000 euro; (ii) sipas mandatpagesës datë 13.1.2017, ka kaluar shuma prej 6,000 euro.

39. Komisioni verifikoi mundësinë financiare të babait të subjektit F. H., për të paguar shumën prej 26,000 euro për të blerë pasurinë objekt shqyrtimi, si vijon:

39.1. Shuma prej 2,720,000 lekësh/20,000 euro e ka burimin te shuma prej 2,800,000 lekësh, e cila ka kaluar nga znj. A. C. në llogari të z. F. H. në datën 22.11.2016, ditë që është revokuar kontrata e lidhur midis tyre me nr. ***, datë 22.7.2015. Këtë shumë z. F. H. e kishte kaluar në favor të znj. A. C. në datën 25.7.2015 (trajtuar më sipër). Sa i takon të ardhurave të ligjshme të babait të subjektit F. H. për krijimin shumës 2,800,000 lekë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe në përgjigjet e dërguara në datën 27.5.2021, subjekti parashtroi se kjo shumë është paguar nga babai i saj në kohën kur ka qenë studente në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës dhe përpara se të emërohej në detyrë, si dhe ka dhënë sqarime të detajuara se si burim i kësaj shume kanë shërbyer:

- kursimet e prindërve ndër vite, për të cilat ka paraqitur disa dokumente shkresore;

⁹Paraqitur edhe nga subjekti bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

¹⁰Paraqitur edhe nga subjekti bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

- kredia e marrë nga babai dhe vëllai i saj pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 850,000 lekë në datën 13.7.2015, për të cilën ka paraqitur kontratën e kredisë;

- shuma e përfituar nga shitja e një pasurie shtetasit L. S. në vitin 2010, në çmimin 3,800,000 lekë për të cilat është vërtetuar pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga shitja, pasi, nga kartela lëshuar për pasurinë e shitur nr. ***, rezultoi se kjo pasuri është regjistruar në emër të blerësit L. S. në datën 11.11.2014¹¹. Ndërsa, nga verifikimi i dokumenteve bankare u vërtetua se: (i) në datën 2.11.2010, shuma prej 3,800,000 lekësh ka kaluar në rrugë bankare nga shtetasi L. S. te shtetasi F. H. në NBG; (ii) një pjesë e saj, shuma prej 2,000,000 lekësh është investuar në depozitë me afat deri në datën 18.11.2014, e cila në datën 22.7.2015, ka kaluar në llogari të znj. A. C. pranë “Credins Bank”; (iii) pjesa tjetër prej 800,000 lekësh e ka burimin te kredia bankare që nëna e subjektit M. H. dhe vëllai i saj Gj. H. kanë marrë në datën 13.7.2015 nga “Raiffeisen Bank”.

39.2. Bazuar në të gjitha të dhënat e administruara, Komisioni kreu një analizë financiare të familjes së origjinës së subjektit për periudhën 2009¹² – 25.7.2015, pasqyruar si në tabelën me poshtë, sipas së cilës rezultoi se babai i subjektit ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të paguar shumën prej 2,800,000 lekësh në datën 25.7.2015, analizë e cila është kryer me metodën kumulative për shkak se familjarët e subjektit nuk kanë qenë subjekte deklaruese, ndërkohë që analiza i përket periudhës përpara se subjekti të bëhej subjekt deklarues.

Familja e origjinës së subjektit	Periudha 2009 - 25.7.2015
Pasuritë	3 739 885
Paguar me kontratën datë 25.7.2015	2 800 000
Për rikonstrukcion banese për të cilën është marrë kredi në NBG	600 000
<i>Shtesa/pakësime/likuiditeteve</i>	339 885
Të ardhurat	13 101 701
Paga <i>neto</i> e babait F. H. nga nëntor 2009	1 294 885
Pensioni i parakohshëm i babait F. H. nga shtator 2011	639 515
Paga <i>neto</i> e nënës M. H.	1 086 542
Paga e subjektit	3 920 857
Paga e motrës N. H.	351 720
Paga e vëllait Gj. H.	264 000
Marrë kredi nga NBG	600 000
Përfituar nga shitja e pronës datë 2.11.2010	3 779 000
Marrë kredi nga “Raiffeisen Bank” datë 14.7.2015	850 000
Përfituar nga interesat bankare	315 182
Shpenzimet	7 462 387
Shpenzime jetike për 5 persona	5 191 183
Shpenzime qiraje	1 185 000
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	360 173
Shpenzime kredie në NBG	46 000
Paguar kredia në NBG	658 381
Paguar për <i>overdraft</i> -in në vonesë, tek Tranzit	21 650
Mundësia për kursime	1 899 428

¹¹Udhëzim nr. 9, datë 26.2.2008, i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, pika 10 parashikon se: “Pagesa e detyrimit tatimor bëhet para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme, në ZVRPP, në përputhje me aktet ligjore”.

¹²Analiza fillon në vitin 2009, pasi në këtë vit subjekti ka filluar të gjenerojë të ardhura.

39.3. Sa i takon shumës prej 6,000 euro të paguara nga babai i subjektit F. H. në datën 13.1.2017, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se kjo shumë është marrë hua pa interes nga shtetasi E. P. (djali i xhaxhait të nënës). Për të vërtetuar këtë pretendim ka paraqitur dokumentet shkresore si vijojnë:

- Kontratë huaje pa akt noterial me datë 12.1.2017, sipas së cilës shtetasi E. P. i jep hua pa interes shtetasve M. dhe F. H. shumën prej 6,000 euro. Në këtë kontratë është përcaktuar se: (i) qëllimi i huas për shlyerjen e një detyrimi kontraktor të huamarrësve ndaj të tretëve për blerjen e banesës në Tiranë; (ii) afati i kthimit të huas është deri më 31.12.2018, me kushtin që nëse shtëpia në Pogradec do të shitej më shpejt se data 31.12.2018, ata duhet të shlyejnë menjëherë huan; (iii) huaja është dhënë dorazi.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.1.2020, ku shtetasi E. P. konfirmon se shuma prej 6,000 euro i është kthyer *cash* në datën 10.7.2017, menjëherë pas shitjes së shtëpisë në Pogradec nga shtetasit M. dhe F. H..

39.4. Në lidhje me mundësinë financiare të huadhënësit E. P. për t'i dhënë huan në shumën 6,000 euro babait të subjektit, në përgjigjet e dërguara në datën 27.5.2021, subjekti ka sqaruar se huaja është marrë dhe shlyer nga prindërit e saj dhe se vetë nuk ka pasur asnjë kontribut në këtë hua dhe se sipas saj, as prindërit e saj dhe as huadhënësi nuk duhet të konsiderohen persona të lidhur. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se shuma prej 6,000 euro e ka burimin nga biznesi privat i huadhënësit dhe nga punësimi i bashkëshortes së tij, si dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore¹³ sipas të cilave rezulton se ky shtetas ka pasur aktivitet privat, por nuk ka provuar pagesën e tatimeve mbi të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet. Po kështu, sipas subjektit, të dy bashkëshortët Pengu kanë qenë aksionerë në shoqërinë “B. T.”, por nuk ka vërtetuar të ardhura të tyre nga kjo shoqëri.

Duke qenë se subjekti ka përdorur apartamentin e babait të saj, një pjesë e çmimit të të cilit është paguar me huan në shumën 6,000 euro të marrë nga shtetasi E. P. gjatë kohës që subjekti ka qenë subjekt deklarues, me kalimin e barrës së provës subjektit i është kërkuar të vijojë të paraqesë dokumente shkresore për të vërtetuar të ardhura të ligjshme të huadhënësit E. P.. Në parashtrimet e saj, subjekti ka paraqitur dokumente mbi të ardhurat e shtetasit E. P. si person fizik¹⁴ dhe bashkëshortes së tij F. P.¹⁵. Gjithashtu, në datën 2.7.2021, Komisioni administroi shkresën kthim përgjigje, datë 29.6.2021, të DPT-së Tiranë, e cila informon se qarkullimi në periudhën 2000 – 2005, për Personin Fizik “E. P.”, rezulton të jetë në shumën 13,600,000 lekë. Ndërsa për vitet 2006 – 2010¹⁶ qarkullimi është konsideruar 2,000,000 lekë/vit bazuar në taksat vendore të paguara gjatë këtyre viteve. Bazuar në këto dokumente, të ardhurat nga aktiviteti privat, si dhe pagat e bashkëshortes së huadhënësit janë në vlerën 6,041,000 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës në shumën 3,125,844 lekë. Pra, huadhënësi kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën 6,000 euro në datën 12.1.2017¹⁷.

39.5. Sa i takon burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për të shlyer huan në vlerën 6,000 euro, në datën 10.7.2017, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka pretenduar se babai i saj

¹³Certifikatë regjistrimi në organin tatimor të vitit 2005, ku rezulton se shtetasi E. P. ka aktivitet tregti me pakicë mallrash industriale dhe pastaj riparim rrobaqepësi; shkresë nr. *** prot., datë 8.1.2020 nga Bashkia Tiranë, e cila informon se xhiroja e personit fizik E. P. është 6-7 milionë lekë/vit dhe se janë likuiduar.

¹⁴Vërtetim nr. *** prot., datë 8.1.2020, i cili vërteton se janë paguar taksat vjetore për Personin Fizik “E. P.” për periudhën 2001 – 2010 dhe qarkullim 6-7 milionë lekë/vit; disa mandatpagesa të taksave vendore të Bashkisë dhe disa formularë për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, për disa muaj përgjatë viteve 2005-2006.

¹⁵Ekstrakt historik i punonjësit, printuar nga DRT-ja Tiranë, në të cilën pasqyrohet paga e shtetasit F. P. për periudhën dhjetor 2011 – mars 2015; lëvizje të llogarisë ku kreditohet paga në “Alpha Bank” për periudhën mars 2009 – shtator 2011.

¹⁶Biznesi ka marrë status pasiv në datën 30.6.2011.

¹⁷Marzhi i fitimit mbi qarkullimin e PF me objekt veprimtarie tregti me pakicë dhe më pas rrobaqepësi është llogaritur 20%.

ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme. Për të vërtetuar këtë pretendim ka paraqitur kontratë shitblerjeje me rezervë nr. ***, datë 3.7.2017, sipas së cilës shitësit F. dhe M. H. (prindërit e subjektit) i kanë shitur blerësit K. K. apartamentin me sip. 87 m²¹⁸, me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në Pogradec, në shumën 2,300,000 lekë¹⁹. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të z. F. H. në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 5.7.2017 është transferuar shuma prej 1,000,000 lekësh nga llogaria e noterit Th. B., në llogarinë e z. F. H. me përshkrimin “kalim shume, kontratë shitblerjeje me rezervë e pronës nr. ***, datë 3.7.2017. Kjo shumë është tërhequr nga z. F. H. në dy pjesë me vlerë nga 500,000 lekë përkatësisht në datat 5 dhe 6 korrik 2017. Shuma prej 1,000,000 lekësh/rreth 7,500 euro duket se ka shërbyer për kthimin e shumës prej 6,000 euro te shtetasi E. P. në datën 10.7.2017. Për rrjedhojë, u vërtetua burimi i ligjshëm i të ardhurave për shlyerjen e huas me vlerë 6,000 euro nga babai i subjektit të rivlerësimit.

40. Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi nuk rezultoi²⁰ që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar çështje ku persona nën hetim të kenë qenë shtetasi L. dhe M. L., si dhe as procedime penale për veprimtari të krimit të organizuar²¹ të regjistruara në emër të tyre.

Në përfundim nuk u evidentuan problematika dhe lidhje të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri.

41. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar si vendqëndrim adresën “Lagjja nr. 1, rr. ‘S.’, p. ***, Pogradec”, me sqarimin se kjo është banesa e dajës ku ka jetuar pjesërisht në vitin 2016, gjatë periudhës së stazhit profesional. Po njësoj është deklaruar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 me sqarimin se në këtë adresë ka jetuar pa qira për shkak të marrëdhënieve familjare dhe ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.1.2020, sipas së cilës shtetasi N. C. deklaroi se subjekti ka jetuar përkohësisht dhe pjesërisht në apartamentin me sip. 98 m², në Lagjen nr. 1, rr. “S.”, p. ***, Pogradec, në pronësi të tij, duke e vërtetuar këtë fakt me certifikatën e pronësisë nr. ***. Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi nuk rezultoi²² që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar çështje ku personi nën hetim të ketë qenë shtetasi N. A. C. dhe as procedime penale për veprimtari të krimit të organizuar²³ të regjistruara në emër të tij.

42. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se nga shtatori i vitit 2019 (kur ka marrë lejen e lindjes) banon dhe përdor objektin e marrë me qira në qytetin e Tiranës, me vendndodhje në rrugën “S.”, p. “****”, shk. ***, ap. ***, k. ***, Tiranë, që i përket periudhës pas deklaratës *Vetting*, për të cilën ka paraqitur kontratën e qirasë së datës 10.9.2019, të lidhur

¹⁸Kjo pasuri ishte përfituar nga privatizimi me kontratën e datës 22.2.1994, të lidhur me NK Banesa Pogradec. Kjo pasuri ishte vendosur si garanci sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 17.2.2020, për kredinë e marrë nga shtetasi F. H., në shumën 600,000 lekë, marrë pranë NBG-së në datën 17.2.2010. Bllokimi është çregjistruar sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 30.11.2020, të Bankës Kombëtare të Greqisë.

¹⁹Nga praktika e rivlerësimit të pasurisë me nr. dosje ***, rezultoi se prona është rivlerësuar me vlerën 4,283,010 lekë në datën 20.3.2012 dhe në këtë datë është paguar edhe tatimi për këtë rivlerësim në shumën 29,347 lekë, vërtetuar me mandatpagesën e NBG-së.

²⁰Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në dosjen e Komisionit.

²¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

²²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në dosjen e Komisionit dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.6.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

²³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit, si dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.6.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

me qiradhënësit G. H. të përfaqësuar nga poseduesi H. B. dhe qiramarrësve E. P. dhe Blerta Hamza. Po kështu, në përgjigjet e këtij pyetësi subjekti ka deklaruar se ka nisur bashkëjetesën me shtetasin E. P. në qershor të vitit 2018, duke paraqitur certifikatë martesë me datë 13.1.2020, sipas së cilës kanë lidhur martesë në datën 8.6.2018. Pra, siç vërehet subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

42.1. Edhe pse në këtë adresë subjekti ka banuar pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, me qëllim verifikimin e çdolloj lidhjeje të saj me këtë pasuri, nga Komisioni iu kërkuan sqarime subjektit, e cila, në përgjigje të pyetësit nr. 2 ka dhënë shpjegime të detajuara për sa i është kërkuar, si dhe ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore, nga verifikimi i të cilave rezultoi se deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësit nr. 1, në lidhje me këtë adresë banimi janë të sakta. Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nuk rezultoi²⁴ që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar çështje, ku persona nën hetim të kenë qenë shtetasit H. B. dhe G. H. dhe as procedime penale për veprimtari të krimit të organizuar²⁵, të regjistruara në emër të tyre.

43. Nga informacioni i administruar nga ASHK-ja²⁶ nuk konfirmohet ndonjë pasuri e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit Blerta Hamza dhe prindërve të saj.

44. E pyetur mbi faktin se ku jetojnë aktualisht prindërit e saj, duke informuar në lidhje me çdo pasuri të mundshme të regjistruar në emër të tyre apo pasuri të porositura/poseduara prej tyre përveç atyre që kishte deklaruar, znj. Blerta Hamza ka deklaruar se aktualisht ata jetojnë në apartamentin me adresë: “Lagjja nr. 3, rruga ‘***’, p. ‘***’, ap. nr. ‘***’, k. ‘***’, Njësia Administrative K., Tiranë” (ndryshuar adresa nga organet shtetërore në vitin 2018, në rrugën ‘P. P.’, p. ‘***’, h. ‘***’, ap. ‘***’, k. ‘***’, Tiranë, përfituar nga babai i saj sipas kontratës kalim të drejtash pronësie, trajtuar më sipër, e cila nuk është regjistruar ende në ZVRPP). Në lidhje me pasuri të tjera të prindërve të saj, subjekti ka vërtetuar me dokumente se:

- babai F. H. ka në pronësi pasurinë e llojit “arë” me sip. 50 m², nr. pasurie ‘***’, në L., Pogradec, blerë me kontratën nr. ‘***’, datë 2.11.2010, në çmimin 26,720 lekë nga shtetaset L. H. (gjyshja e subjektit nga babai), si dhe T. Xh. H. (motra e babait të subjektit);

- nëna M. H. ka në pronësi të sajën 1/35 e pasurive: (i) pasuri e llojit truall me sip. 300 m² prej të cilave 80 m² ndërtesë me nr. pasurie ‘***’; (ii) pasuri e llojit “arë” me sip. 430 m², me nr. pasurie ‘***’; (iii) pasuri e llojit “arë” me sip. 814 m², me nr. pasurie ‘***’.

Gjatë procesit të rivlerësimit nuk u evidentuan lidhje të subjektit me këto pasuri.

45. Nga informacioni i administruar nga FSHU-ja²⁷ nuk kanë rezultuar kontrata të furnizimit me energji në emër të znj. Blerta Hamza, ndërkohë që për babanë F. H. është informuar për një kontratë furnizimi me energji elektrike me nr. ‘***’ në instancën K., Berat. Subjekti, pasi u pyet, sqaroi se kjo kontratë nuk i përket babait të saj dhe as dikujt tjetër në familjen e saj. Për të vërtetuar këtë pretendim ka paraqitur shkresën kthim përgjigje nr. ‘***’ prot., datë 30.4.2021, nga OSSH-ja, sipas së cilës me të dhënat F. F. H. i datëlindjes 20.2.1962, me nr. identifikimi ‘***’, nuk figuron e hapur asnjë kontratë energjie.

²⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ‘***’ prot., datë 12.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në dosjen e Komisionit dhe shkresë kthim përgjigje nr. ‘***’ prot., datë 11.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. ‘***’ prot., datë 1.6.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

²⁵Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ‘***’ prot., datë 14.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

²⁶Shihni shkresat e ASHK-së në kthim përgjigje të shkresës nr. ‘***’ prot., datë 16.1.2020, të Komisionit, në dosjen e Komisionit.

²⁷Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ‘***’ prot., datë 4.2.2020, të FSHU-së në dosjen e Komisionit.

46. UKT-ja nuk ka konfirmuar kontrata për shërbime ujësjellës-kanalizime në emër të subjektit dhe prindërve.

47. ASHK-ja, zonat e stimuluar, ka informuar se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit nuk rezultojnë të jenë aplikues për ndonjë objekt informal.

48. Nga verifikimi i regjistrit noterial në lidhje me subjektin e rivlerësimit dhe prindërit nuk rezultuan akte noteriale të ndryshme nga ato të evidentuara gjatë hetimit administrativ.

49. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezultoi se subjekti ka udhëtuar me automjetet me targa si vijojnë: AA ***; AA ***; AA ***; AA ***; AA ***; AA ***; AA ***; KO ***; AA ***; TR ***; TR ***; TR ***; AA ***. E pyetur mbi pronarët e automjeteve, marrëdhënien me ta dhe qëllimin e udhëtimeve, subjekti ka dhënë deklarime të detajuara në lidhje me pronarët e tyre, të cilët u verifikuan nga Komisioni edhe në sistemin AMF. Nga të dhënat e këtij sistemi kanë rezultuar disa shtetas të tjerë, veç atyre të deklaruar nga subjekti, në cilësinë e përdoruesit/pronarit ose policëmbajtësit me periudha të ndryshme kohore. Për këtë arsye, me kalimin e barrës së provës subjektit i është kërkuar të vërtetojë me dokumente shkresore që nuk ka shqyrtuar çështje, ku palë pjesëmarrëse në proces të kenë qenë shtetasit F. C., E. A., S. N., F. K. dhe A. K., të cilët në sistemin AMF rezultuan si pronarë apo përdorues të disa prej automjeteve. Në parashtrimet e saj, subjekti ka paraqitur përgjigjet e prokurorive Shkodër dhe Pogradec, sipas të cilave nuk rezultoi që prokurorja Blerta Hamza të ketë shqyrtuar çështje ku pjesëmarrës me çfarëdoq statusi të kenë qenë këta shtetas²⁸. Në përfundim të procesit nuk kanë rezultuar të dhëna për një konflikt të mundshëm interesi të subjektit me të gjithë shtetasit që kanë qenë pronarë apo përdorues të automjeteve të rezultuara në sistemin *TIMS*, apo për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale.

Pasi është evidentuar se subjekti ka banuar në Tiranë, ndërkohë që ka kryer stazhin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në periudhën shtator 2015 – shtator 2016, dhe nga tetori i vitit 2016 ka punuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është pyetur për shpenzimet e transportit nga vendbanimi në vendin e punës dhe, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me shpenzimet e transportit, të cilat u përfshinë në analizën financiare.

Analiza financiare

50. Nga ana e Komisionit, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, është kryer analiza financiare që nga data e emërimit të subjektit në detyrë deri në fund të vitit 2016, sipas të cilës subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit.

Përshkrimi	14/9 – 31.12.2015	2016	Totali
Pasuritë	775 206	307 955	1 083 160
Kursime <i>cash</i> të krijuara nga subjekti	800 000	400 000	1 200 000
<i>Shtesa /pakësime Banka</i>	-24 794	-92 045	-116 840
Detyrimet	63 776	-63 776	0
Kredi në “Raiffeisen Bank” për blerje në “Neptun”	63 776		63 776
<i>Shlyer principal kredie 63,776 lekë</i>		-63 776	-63 776
Pasuri neto	711 430	371 731	1 083 160

²⁸ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.6.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.6.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec bashkëngjitur parashtrimeve në dosjen e Komisionit.

Të ardhurat	1 032 179	1 076 337	2 108 516
Të ardhura nga paga e subjektit	232 179	1 076 337	1 308 516
Depozitat <i>cash</i> të kursyera para detyrës	800 000		800 000
Shpenzimet	199 060	418 199	617 260
Shpenzime jetese për një person	65 414	136 620	202 034
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	8 271	175 725	183 996
Shpenzime transporti	61 600	98 000	159 600
Shlyer interesa kredie		4 854	4 854
Paguar komisione në bankë		3 000	3 000
Blerje mallrash konsumi (<i>sipas kredive të marra</i>)	63 776		63 776
Mundësia për kursime	121 689	286 407	408 096

Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare

51. Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

51.1. Të ardhurat

-Të ardhurat nga punësimi të dokumentuara të subjektit përfshirë: pagat për periudhën para emërimit në detyrë²⁹; si dhe pagat duke filluar nga emërimi në detyrë më 14.9.2015 dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit³⁰. Subjekti është analizuar me familjen e saj të origjinës deri në momentin para fillimit të detyrës.

-Të ardhurat e familjarëve të saj³¹, sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, janë përfshirë në analizën financiare para emërimit në detyrë të subjektit; si dhe të ardhurat nga shitja e pronës³² dhe kreditë bankare³³ të familjarëve të saj.

51.2. Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për pesë persona, sipas përbërjes familjare të subjektit dhe bazuar në standardin e ILDKPKI-së nga viti 2009 deri më 14.9.2015 dhe për një person nga kjo datë deri në fund të vitit 2016.

- Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur sipas sistemit *TIMS* dhe sqarimeve e dhëna nga subjekti³⁴.

- Shpenzimet e qirasë janë përlllogaritur sipas kontratave të qirasë të lidhura nga babai i subjektit.

- Blerja e produktit nëpërmjet kredisë nga “Raiffeisen Bank”.

- Pagesat e interesave të kredive konsumatore dhe komisionet bankare.

²⁹Vërtetim nr. ***, datë 18.10.2016, për punësimin pranë ZVRPP-së për periudhën 3.6.2009 – 30.12.2013 dhe vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës si studente magjistrature për periudhën 2014 – 2015.

³⁰ Vërtetim nr. ***, datë 24.10.2016, si prokurore në stazh në Pogradec për periudhën 14.9.2015 – tetor 2016; vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, datë 9.1.2017, për periudhën 17.10.2016, dhe në vijim.

³¹Shihni dokumentet e përmendura në analizën e pasurisë nr. 3, në këtë vendim.

³²Shitblerja është kryer në datën 2.11.2011, vërtetuar më statement nga NBG-ja.

³³Kredi në shumën 600,000 lekë marrë në NBG në datën 26.2.2010 dhe kredi në shumën 850,000 lekë nga “Raiffeisen Bank” në datën 14.7.2015.

³⁴Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit.

- Shpenzimet e transportit nga vendbanimi në vendin e punës: (i) për periudhën shtator 2015 – janar 2016, me automjete të linjës Tiranë-Pogradec, janë përlogaritur 22 ditë pune në muaj dhe çmimi i biletës 800 lekë për një udhëtim; (ii) gjatë vitit 2016 ka udhëtuar me automjete të linjës Tiranë-Pogradec, vetëm në fundjave apo festive. Për këtë periudhë janë përlogaritur 5 udhëtime në muaj dhe çmimi i biletës 800 lekë për një udhëtim; për periudhën nga tetori 2016, kur subjekti është emëruar në Shkodër, deri në janar 2017, ka udhëtuar me automjete të linjës me çmimin që varion 800-1,000 lekë, vajtje-ardhje. Për këtë periudhë janë përlogaritur 22 ditë pune në muaj dhe çmimi i biletës 1,000 lekë për një udhëtim.

51.3. Pasuritë

- Likuiditeti *cash* në shumën 1,200,000 lekë.

- Gjendjet e llogarive bankare³⁵ të subjekti dhe të familjarëve të saj në fund të çdo viti/date të analizuar.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

51.4. Detyrimet

- Kredia konsumatore e marrë nga subjekti në “Raiffeisen Bank” dhe shlyerjet e principalit të kredisë.

51.5. Pasuria *neto* është diferenca e pasurisë me detyrimet. Rezultati financiar është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total. Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhura – (shpenzime + pasuri *neto*), për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë

52. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza: (i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); (iii) subjekti nuk ka kryer fshehje pasurie (germa “c” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); (iv) subjekti nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të neni 59, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

53. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Blerta Hamza, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***,

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2020 nga “Raiffeisen Bank”; shkresë *** prot., datë 30.1.2020, nga BKT; shkresë nr.*** prot., datë 22.1.2020, nga “Tirana Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2020, nga “ProCredit Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 27.1.2020, nga “ABI Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 5.2.2020, nga “Credins Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020, nga “Union Bank”.

datë 6.2.2020, të KDZh-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga subjekti në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Blerta Hamza.

53.1. Pas kërkesës së Komisionit, për përditësimin e të dhënave me shkresë konfidenciale, DSIK-ja informoi se për këtë subjekt nuk disponohen të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme. Gjatë procesit të rivlerësimit, nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim, si dhe u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, në përfundim të procesit, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza është e përshtatshme për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

54. Gjatë procesit të rivlerësimit, është kryer rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Blerta Hamza në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

55. Rivlerësimi i aftësive profesionale është bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. *** prot, datë 3.6.2021, nga ku rezultoi se subjekti është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, si vijon:

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza, tregon korrektësi në zbatimin e ligjit dhe identifikon drejtë normën ligjore të zbatueshme. Aktet janë përgatitur, në respektim të dispozitave procedurale penale dhe Urdhrit nr. 174, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, ka respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdorë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, kryerja e hetimeve është brenda afateve sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mos përgatitjen e tij për çështjen në gjykim. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet. Referuar të dhënave statistikore për punën e kryer, rezulton se prokurorja ka përballuar me efikasitet një

ngarkesë të lartë pune. Në analizë të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Blerta Hamza, është efiçente dhe efektive.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Blerta Hamza, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe Shkodër. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e gjykatës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorja Blerta Hamza, nuk është marrë asnjë një masë disiplinore.

b) Integriteti

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Prokurorja Blerta Hamza i nënshtrohet Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, ku në periudhën shtator 2015 - tetor 2016 është angazhuar në nëntë aktivitete profesionale (seminar) të organizuar prej saj, ku ka qenë pjesëmarrëse në një trajnim jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

56. Rivlerësimi i aftësive profesionale është bazuar edhe në informacionin e marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar: (i) tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të

cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj; (ii) dhjetë denoncime nga publiku të administruara për subjektin e rivlerësimit sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

57. Denoncuesi P. N.³⁶ denoncon prokurorët A. B., F. K. dhe Blerta Hamza, për shpërdorim detyre, si dhe fshehje të të gjitha fakteve e rrethanave reale të çështjes që i përket dy fëmijëve të tij të mitur, të cilët kanë humbur jetën në një aksident automobilistik. Në lidhje me prokuroren Blerta Hamza, denoncuesi ngrinte pretendime për njëanshmëri, moskryerje dhe zvarritje hetimesh për tetë muaj, pas kthimit për rihetim të çështjes në Prokurorinë e Rrethit Shkodër.

57.1. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, subjektit iu kërkuan sqarime, mbi veprimet hetimore konkrete të kryera prej saj dhe për çdo zgjatje të afatit të hetimeve. Në përgjigjet e saj³⁷, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit, ka pranuar se hetimet për çështjen kanë zgjatur afërsisht 8 muaj por kjo lidhej me faktin se çështja ka qenë komplekse dhe sensitive. Subjekti ka sqaruar se ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për zbardhjen e të vërtetës dhe përveç kësaj janë kryer edhe veprimet hetimore shtesë të kërkuara nga denoncuesi dhe prej saj nuk është bërë zgjatje e afatit hetimor pasi kjo çështje është regjistruar pa autor. Më tej, subjekti ka sqaruar se pavarësisht organit të akuzës për zbardhjen me objektivitet dhe paanshmëri të çështjes, denoncuesi ka ngritur vazhdimisht pretendime për diskriminim, anshmëri, korrupsion dhe gjuhë fyese e ofenduese dhe, për këtë arsye, ajo ka paraqitur ndaj tij kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

57.2. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur kopjen e dosjes së procedimit penal nr. ***, datë 8.3.2017, nga aktet e së cilës konstatohet se:

- me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal të datës 8.3.2017, prokurorja Blerta Hamza ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “kryerje e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal;

- bazuar në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 20.3.2017, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: në datën 15.5.2017 është administruar CD me pamjet filmike të aksidentit, dhe është pyetur shtetasi P. N.; në datën 25.5.2017 është pyetur shtetasi K. N. dhe M. F.; në datën 29.5.2017 janë këqyruar dhe janë marrë provat materiale që i përkasin procedimit penal nr. *** dhe procedimi penal nr. *** të vitit 2016; në datën 4.6.2017 është pyetur përsëri shtetasi P. N.; në datën 14.6.2017 janë pyetur shtetasit Gj. Z. dhe Z. M.; në datën 19.6.2017 janë pyetur shtetasit L. N., A. N., M. H. dhe L. Gj.; në datën 21.6.2017 janë pyetur shtetasit A. B., K. D. dhe M. P.; në datën 7.7.2017 janë pyetur shtetasit E. H. dhe A. H.; në datën 13.7.2017 është pyetur shtetasi J. N.; në datën 6.9.2017 është pyetur shtetasi P. N.; në datën 11.9.2017 është caktuar ekspert dhe kryerja e ri ekspertimit autoteknik, i cili është kryer në datën 27.9.2017, si dhe janë caktuar pyetjet për ekspertët brenda datës 30.9.2017; në datën 28.9.2017 është pyetur shtetasi D. Q.; në datën 2.10.2017 është pyetur shtetasi N. Q.; në datën 2.10.2017 janë kryer dy seanca ballafaqimi; është kërkuar informacion mbi shtetasit K. Gj. dhe R. N. etj;

- me kërkesën e datës 23.10.2017, prokurorja Blerta Hamza ka kërkuar pushimin e çështjes penale nr. ***, datë 8.10.2017;

³⁶Shihni denoncim nga shtetasi P. N., përcjellë dhe protokolluar me nr. *** prot., datë 20.1.2020, në Komision dhe denoncim nga P. N., protokolluar me nr. *** prot., datë 20.3.2018, në Komision.

³⁷Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, protokolluar me nr. *** prot., datë 27.5.2021, në Komision.

- me vendimin nr. ***, datë 7.6.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit dhe kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, duke arsyetuar se vetëm pasi të hetohet në mënyrë të plotë dhe objektive (ekspertim të ri autoteknik me grup ekspertësh), mund të konkludohet nëse jemi ose jo përpara veprave penale për të cilat është regjistruar ky procedim penal;

- pas ankimit të këtij vendimi nga ana e prokurorisë, Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 16.8.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 7.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***.

57.3. Nga analiza e këtyre akteve shkresore, përkundër sa pretendohet nga denoncuesi, rezultoi se: (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime të shumta hetimore, që nga data e regjistrimit të procedimit penal më 8.3.2017 dhe deri në datën e paraqitjes së kërkesës për pushimin e çështjes më 23.10.2017; (ii) për sa i takon afatit të hetimeve, referuar urdhrit të regjistrimit të procedimit penal, konstatohet se çështja objekt shqyrtimi është regjistruar pa autor dhe, për pasojë, çështja nuk përfshihet në kushtet e parashikuara në nenin 332/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili kërkon kryerjen e hetimeve paraprake brenda një afati 3-mujor. Veç kësaj, vlen të theksohet se vendimi i prokurores Blerta Hamza për pushimin e çështjes është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe në përfundim është vlerësuar e drejtë nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 16.8.2018.

57.4. Gjithashtu, rezulton të jetë i vërtetë deklarimi i subjektit se ka bërë kallëzim penal ndaj denoncuesit për veprën penale “fyerje e gjyqtarit”, referuar shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, drejtuar denoncuesit P. N. në datën 28.1.2018. Denoncimet e denoncuesit mbajnë datat 28.3.2018 dhe 20.1.2020.

57.5. Në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, nuk u konstatuan problematika në veprimet e procedurale të kryera nga prokurorja Blerta Hamza gjatë hetimit të çështjes.

58. Denoncuesi D. P.³⁸ në denoncimin e tij ka ngritur dyshime se prokurorja Blerta Hamza ka shmangur me dashje hetimin e faktit se përse ka pasur dy kontrata shitblerje për të njëjtën pronë të lidhur mes EKB-së Shkodër dhe shtetasit D. P.. Sipas tij, kjo është bërë me qëllim për të fshehur mashtrimet e bëra nga shtetasi L. K., ish-drejtor i EKB-së Shkodër.

58.1. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me mungesën e hetimeve mbi ekzistencën e dy kontratave të shitblerjes për të njëjtën pronë, duke vërtetuar me dokumente kryerjen e veprimeve hetimore konkrete. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se pretendimet e denoncuesit për mungesën e hetimeve mbi ekzistencën e dy kontratave të shitblerjes nuk qëndrojnë, pasi këto dy kontrata janë administruar prej saj dhe gjenden në dosjen e procedimit penal nr. ***, të cilat janë përkatësisht kontrata e shitjes me kusht nr. ***, datë 13.11.2000 dhe kontrata e shitjes së menjëhershme nr. ***, datë 29.3.2012, e cila është lidhur pas plotësimit të kushtit të parashikuar në kontratën e parë.

58.2. Subjekti ka sqaruar se objekti i hetimit të çështjes nuk ka qenë falsifikimi i këtyre kontratave, por falsifikimi i certifikatës familjare nga denoncuesi me qëllim përfitimin e një prone që nuk i takonte nga EKB-ja, fakt ky i provuar me aktekspertim. Kështu, sipas saj në përfundim të hetimeve organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se veprat penale “mashtrimi në subvencione” dhe “falsifikimi i akteve të gjendjes civile” janë parashkruar dhe, në këto

³⁸Shihni kallëzimin penal nga shtetasi D. P., protokolluar me nr. *** prot., datë 20.11.2020, në Komision.

kushte, i është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër pushimi i hetimeve për këto vepra penale.

58.3. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur kopje të akteve të dosjes së procedimit penal nr. ***, datë 8.6.2017, nga të cilat konstatohet se:

- Me urdhrin e datës 8.6.2017, prokurorja Blerta Hamza ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës “mashtrimi në subvencione” të parashikuar nga neni 144 dhe “falsifikimi i akteve të gjendjes civile” të parashikuar nga neni 191 të Kodit Penal. Në këtë vendim referohet se: “... shtetasi D. P. më anë të kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 13.11.200, ka blerë nga Drejtoria Rajonale e EKB-së një apartament banimi me sipërfaqe... Kjo kontratë është firmosur nga shtetasit D. dhe M. P. në cilësinë e palës blerëse dhe i referohet certifikatës familjare e cila pasqyron gjendjen familjare në vitin 1991, ku anëtare të saj figurojnë veç dy bashkëshortëve edhe tre fëmijë konkretisht G. P. e datëlindjes 1.6.1981; S. P. e datëlindjes 23.3.1983 dhe M. P. e datëlindjes 10.10.1984. Pas plotësimit të kushtit të parashikuar në kontratë midis palëve është lidhur kontrata e shitjes së menjëhershme nr. ***, datë 29.3.2012, e cila është regjistruar në ZVRPP-në Shkodër dhe blerësit janë pajisur me certifikatë pronësie. Nga verifikimet e kryera rezulton se certifikata familjare e paraqitur nga shtetasi D. P. me qëllim blerjen e apartamentit nga EKB-ja, blerje e cila është subvencionuar në ½ pjesë nga shteti, nuk paraqet moshën reale të tre fëmijëve pasi në të vërtetë ato janë secila 10 vjet më e vogël se sa është paraqitur në certifikatën familjare”.

- Në zbatim të urdhrin të datës 8.6.2017 janë administruar praktika e plotë e aplikimit dhe shitjes së pasurisë, pyetja e shtetasve, administrimi i certifikatës familjare të shtetasit D. P. të vitit 1992 etj.

- Me kërkesën e datës 11.10.2017, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, prokurorja Blerta Hamza, ka kërkuar pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, datë 8.6.2017, për veprën “mashtrimi në subvencione”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 144 dhe 25 të Kodit Penal dhe “falsifikimi i akteve të gjendjes civile”, parashikuar nga neni 191 i Kodit Penal, si dhe në nenin 190/b të Kodit të Procedurave Penale, asgjësimin e certifikatës origjinale të administruar në dosjen e aplikimit të shitjes së pasurisë.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. ***, datë 8.11.2017, vendosi pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në ngarkim të shtetasve D. P. dhe M. P., si dhe rrëzimin për pjesën tjetër të kërimit. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, me ndryshimin që në bazë të nenit 190/b të Kodit të Procedurave Penale, certifikata origjinale datë 20.9.200 e administruar në dosjen e aplikimit dhe shitjes së pasurisë nga EKB-ja nga shtetasit D. dhe M. P. të asgjësohet përmes shënimit në të si e deklaruar e falsifikuar me këtë vendim gjyqësor.

58.4. Nga dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përkundër sa pretendohet nga denoncuesi, rezultoi se objekti i hetimit të çështjes nuk kanë qenë dy kontratat e shitblerjes, të cilat janë administruar nga subjekti i rivlerësimit, por certifikata familjare e paraqitur prej tij me qëllim përfitimin e apartamentit nga EKB-ja. Vendimmarrja e prokurores është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, ku në përfundim kjo vendimmarrje është gjetur e drejtë dhe është pranuar nga Gjykata e Apelit Shkodër.

58.5. Në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, nuk u konstatuan problematika në veprimet e procedurale të kryera nga prokurorja Blerta Hamza gjatë hetimit të çështjes.

59. Denoncim anonim³⁹, nga një punonjës i administratës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili ka ngritur pretendime se prokurorja Blerta Hamza e detyruar nga prokurori A. M., asokohe drejtues, ka kërkuar vendosjen e sekuestros preventive për prona të të tretëve të blera në mirëbesim dhe, më pas, ishte tërhequr nga kërkesa. Pavarësisht se denoncuesi nuk ka referuar rastin konkret për të cilin bëhet fjalë, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë provë bashkëngjitur, me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, subjektit iu kërkuar të japë sqarime mbi rastet në të cilat ajo ka kërkuar vendosjen e sekuestros preventive, si dhe rastet për të cilat ajo është tërhequr nga kjo kërkesë.

59.1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka informuar Komisionin se në kuadër të procedimit penal nr. ***, datë 10.3.2016, të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i ka kërkuar gjykatës vendosjen e sekuestros preventive. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata dhe vendimi i saj i është përcjellë ZVRPP-së Malësi e Madhe. Kjo çështje penale është dërguar për gjykim dhe aktualisht është ende duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Masa e sekuestros preventive vazhdon të jetë në fuqi, dhe prej saj nuk i është kërkuar gjykatës heqja e masës së sekuestros së vendosur dhe vendimi nr. ***, i gjykatës deri në këtë fazë nuk është ndryshuar. Për të mbështetur pretendimet, subjekti ka paraqitur kopje të akteve të administruara në dosjen e procedimit penal nr. ***, datë 10.3.2016, nga të cilat nuk rezulton që prokurorja Hamza të jetë tërhequr nga kërkesa e saj për vendosjen e sekuestros preventive në kuadër të procedimit penal nr. ***, datë 10.3.2016.

59.2. Në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, nuk u konstatuan problematika në veprimet e procedurale të kryera nga prokurorja Blerta Hamza, gjatë trajtimit të çështjes.

60. Denoncuesi P. G.⁴⁰ ngrinte pretendime për njëanshmëri të trajtimit e çështjes së tij, nga ana e prokurores Blerta Hamza, e cila sipas tij, nuk ka përmbushur detyrat e caktuara me vendimin nr. ***, datë 3.12.2015, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 24.6.2017, nga Gjykata e Apelit Shkodër.

60.1. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, subjektit iu kërkuar të japë sqarime mbi veprimet hetimore të kryera, të lëna si detyrë nga gjykata. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti duke dhënë sqarime të hollësishme për të gjitha veprimet hetimore konkrete të kryera prej saj, ka deklaruar se pretendimet e denoncuesit për njëanshmëri në trajtimit e çështjes së tij dhe moskryerje e detyrave të lëna nga gjykata, janë thjesht hamendësime dhe të pabazuara. Sipas saj, ato shprehin pakënaqësinë e tij për humbjen e të gjitha proceseve gjyqësore, në përfundim të të cilave është provuar se ai pretendonte një të drejtë që nuk i takonte.

60.2. Për të mbështetur pretendimet, subjekti ka paraqitur kopje të akteve të dosjes së procedimit penal nr. ***, datë 20.3.2015, nga përmbajtja e të cilave konstatohet se:

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 20.3.2015, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës” dhe në përfundim të hetimeve paraprake nga ana e prokurorit të çështjes A. S. është vendosur pushimi i procedimit penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.

- Ky vendim është prishur me vendimin nr. ***, datë 3.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 24.6.2016, nga Gjykata e Apelit Shkodër, duke caktuar një sërë detyrash për organin e akuzës.

- Pas vendimeve gjyqësore, çështja i kaloi me short prokurores Blerta Hamza e cila ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore, në përfundim të të cilave me vendimin e datës

³⁹Shihni letër e hapur, protokolluar me nr. *** prot., datë 9.1.2020, në Komision.

⁴⁰Shihni denoncim nga shtetasi P. G., protokolluar me nr. *** prot., datë 11.09.2018, në Komision.

27.7.2017 ka kërkuar pushimin e procedimit penal. Ky vendim është ankimuar nga ana e denoncuesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. ***, datë 6.4.2018, ka rrëzuar kërkesën e denoncuesit, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 28.6.2018, edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër.

60.3. Në përfundim, nga analiza e dokumentacionit të mësipërm, rezultoi se subjekti ka kryer pjesën më të madhe të veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, por nuk ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) marrja nga ALUIZNI e praktikës së legalizimit të shtetasit P. G. për të përcaktuar sipërfaqen ndërtimore pa leje, llojin e punimeve, tabelat fotografike nëse ka, vitin e ndërtimit; dhe (ii) këqyrja e regjistrimit të protokollit të ZVRPP-së Shkodër për të verifikuar komunikimet e brendshme të shtetasit N. K. me vartësit e tij lidhur me praktikën e regjistrimit të pasurive të shtetasit M. B. dhe ankuesit P. G..

60.4. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuar të japë sqarime mbi konstatimet në lidhje me mungesën e kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore dhe në parashtrimet e saj të datës 29.6.2021, subjekti ka sqaruar:

- Në lidhje me detyrën e parë, nga ana e ALUIZNI-t është vendosur përjashtimi nga procesi i legalizimit të objektit të shtetasit P. G., e për pasojë, pranë ALUIZNI-t nuk ka pasur asnjë praktikë legalizimi që mund të administrohej nga organi i akuzës, pasi ky objekt nuk është legalizuar asnjëherë. Megjithatë nga ana e organit të akuzës është administruar shkresa nr. *** prot., datë 2.11.2011, e Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t Tiranë, drejtuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Shkodër, në të cilën sqarohet se objekti i aplikuar për legalizim nga shtetasi P. G. është ndërtuar në zonën e qendrës historike të qytetit dhe, si i tillë, është përjashtuar nga procesi i legalizimit.

- Në lidhje me detyrën e dytë, në librin e protokollit të institucionit pasqyrohet korrespondenca e institucionit që përfaqësohet nga drejtuesi i tij (regjistruesi), me institucionet e tjera dhe personat e interesuar, pra, shtetasit që aplikojnë apo kërkojnë nga ZVRPP kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Ndërsa me vartësit e tij, regjistruesi komunikon me anë të urdhrave të brendshëm, me anë të të cilave urdhërohen të kryejnë apo moskryerjen e veprime të ndryshme në praktikën e regjistrimit të pasurisë. Më tej, subjekti ka informuar se organi i akuzës ka administruar gjithë praktikën e regjistrimit të pasurisë së shtetasve M. B. dhe P. G., dhe në këtë praktikë ndodhen të administruara të gjitha urdhrat e regjistruetit N. K.. Në rast se vartësit do të kishin pasur kundërshtime për zbatimin e urdhrave të regjistruetit ata do të kishin hartuar relacion, i cili administrohet në referencën përkatëse të regjistrimit të pasurisë.

60.5. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit të cilat i shprehu në mënyrë të qartë dhe të detajuar edhe në seancë dëgjimore janë bindëse dhe të bazuara në prova, pasi nga verifikimi i akteve të dosjes penale rezultoi se nga ana e organit të akuzës është administruar shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.11.2011, e Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t drejtuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Shkodër, ku informohet për përjashtimin nga procesi i legalizimit të objekteve të vetëdeklaruar nga shtetasi P. G.. Po kështu, organi i akuzës ka administruar edhe praktikën e regjistrimit të pasurisë së shtetasve M. B. dhe P. G.. Nga këto veprime vërehet se janë ezauruar të gjitha detyrat e caktuara nga gjykata. Po kështu, Komisioni ka mbajtur në konsideratë edhe faktin se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor në dy shkallë të gjykimit, dhe në përfundim është gjetur e drejtë dhe pa mangësi.

61. Denoncuesja R. Q.⁴¹ ngrinte pretendime për moskryerje hetimesh nga ana e prokurores Blerta Hamza, dhe ndryshim të cilësimit juridik të veprës, duke mospasqyruar në vendim as provat materiale të mbledhura nga prokurorja e mëparshme A. M.. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi pretendimet e denoncueses, e cila në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, sqaroi se bashkëshortët Q., kanë pasur një kalvar të gjatë në organet e drejtësisë, i cili kishte nisur përpara se subjekti të merrte detyrën e prokurores. Sipas saj, këta shtetas kanë humbur të gjitha gjyqet civile, duke pretenduar të drejta pronësie që nuk u takojnë, e për pasojë, gjithmonë kanë shfaqur pakënaqësi. Më tej, ka sqaruar se për çështjen janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe se nuk ka bërë ndryshim të cilësimit juridik të veprës në kundërshtim me vendimin e gjykatës, por ka qenë gjykata që ka urdhëruar organin e akuzës të vazhdonte hetimet për veprën “pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”. Subjekti ka sqaruar se për shkak të gjuhës së fyese dhe kërcënuese të denoncuesve ka dhënë dorëheqjen nga çështja dhe ka bërë kallëzim penal ndaj bashkëshortit të denoncueses, shtetasit M. Q..

61.1. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur kopje të akteve të administruara në dosjen e procedimit penal nr. ***, datë 28.7.2016, nga verifikimi i të cilave u konstatua se:

- Me urdhrin e datës 28.7.2016, prokurorja A. M. ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “pastrim të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal dhe në datën 12.10.2016 është urdhëruar prej saj kryerja e veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. ***, datë 19.5.2015, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 7.7.2016, nga Gjykata e Apelit Shkodër. Nga kjo prokurore janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: në datën 26.10.2016 janë administruar akte nga AKKP-ja Tiranë; dhe në datën 7.11.2016 është marrë deklarimi i shtetasit M. Q..

- Me vendimin e datës 19.12.2016, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër është vendosur zëvendësimi i prokurores A. M. me prokuroren Blerta Hamza, për vazhdimin e hetimeve të procedimit penal nr. **. Nga prokurorja Blerta Hamza në datën 20.1.2017 është vendosur marrja e akteve nga procedimet e tjera; në datat 30.3.2017, 3.4.2017, 4.4.2017 dhe 5.4.2017 janë pyetur shtetasit Gj. S., K. Sh., R. L. dhe K. B..

- Me vendimin e datës 10.4.2017, prokurorja Blerta Hamza ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe, më pas, ka paraqitur një ankim ndaj shtetasit M. Q. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi sipas saj, ky shtetas kishte konsumuar elementët e veprës penale të fyerjes së gjyqtarit dhe, për këtë arsye, ka hequr dorë edhe nga përfaqësimi i çështjes penale nr. ***, datë 28.7.2016. Më pas çështja i ka kaluar për përfaqësim prokurores E. N. dhe më pas A. H..

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 18.2.2018, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 10.4.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 28.6.2016, të prokurores Blerta Hamza dhe detyrimin e organit të prokurorisë për të vazhduar hetimet, duke arsyetuar se nga ana e prokurorisë nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në përputhje me detyrat e ngarkuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. ***, datë 19.05.2015, i formës së prerë.

61.2. Nga analiza e dokumentacionit të administruar si më sipër, ashtu sikurse është arsyetuar edhe në vendimin nr. ***, datë 18.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga ana e

⁴¹Shihni denoncim nga shtetasja R. Q., protokolluar me nr. *** prot., datë 11.09.2018, në Komision.

organit të prokurorisë nuk janë kryer veprimet hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. ***, datë 19.5.2015, konkretisht: (i) nuk është bërë verifikimi pranë EKB-së në lidhje me mënyrën e kalimit të pronës objekt konflikti në favor të shtetit; (ii) nuk është përmbushur plotësisht detyra e ngarkuar nga gjykata lidhur me verifikimet në lidhje me marrjen në dorëzim të dosjes nr. ***, në emër të shtetasve R. L. etj., si dhe personin që ka dorëzuar tek ish-nëpunësi i Bashkisë Shkodër, shtetasi Gj. S.; (iii) nuk është hetuar dhe verifikuar pranë inventarit të pronave shtetërore pranë Bashkisë Shkodër origjina e vërtetë e pronës objekt gjykimi bazuar në të dhënat e pronës, vendndodhja, struktura, sipërfaqja, etj. Ndërkohë, për sa i takon pretendimit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës, nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nuk qëndron, pasi procedimi penal është regjistruar nga prokurorja e mëparshme A. M. për veprën penale “pastrim të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

61.3. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi konstatimet në lidhje me mungesën e kryerjes së këtyre veprimeve hetimore, për të cilat në parashtrimet e saj të datës 29.6.2021, ka sqaruar se prej saj në asnjë rast nuk është shmangur apo neglizhuar kryerja e detyrave të lëna nga gjykata, por ato janë konsideruar të ezazuara prej saj me administrimin e dokumentacionit (praktika e procedurës së ndjekur për marrjen e vendimit nr. ***, datë 27.9.1996, të KKKP-së, si dhe vendimi nr. ***, datë 20.6.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër), që i jep përgjigje këtyre detyrave lidhur me origjinën e pronës objekt gjykimi bazuar në të dhënat e pronës, vendndodhja, struktura sipërfaqja etj., si dhe mënyrën e kalimit të pronës objekt konflikti në favor të shtetit. Për sa i takon detyrës për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të dosjes nr. ***, në emër të shtetasit R. L. dhe personin që ka dorëzuar tek ish-nëpunësi i Bashkisë Shkodër shtetasit Gj. S., subjekti ka sqaruar se të dy këta shtetas janë pyetur në interes të hetimit dhe kanë sqaruar se kërkesat e subjekteve të interesuar për kthimin dhe kompensimin e pronave janë dorëzuar pranë Komisionit dhe jo në sekretari. E gjithë praktika e ndjekur nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesës së trashëgimtarëve Kakarriqi dhe marrjes së vendimit përkatës është administruar nga organi i akuzës.

61.4. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat i shprehu në mënyrë të qartë dhe të detajuar edhe në seancë dëgjimore, janë bindëse dhe të bazuara në prova, pasi nga verifikimi i akteve të dosjes penale, rezultoi se nga veprimet e kryera nga organi i akuzës janë ezauruar detyrat e lëna nga ana e autoritetit gjyqësor.

62. Denoncuesi G. T.⁴² ngrinte pretendime për zvarritje të hetimeve të çështjes së tij. Sipas tij, çështja është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 1.12.2015 dhe fillimisht i është caktuar prokurores E. N., e cila e mbajti deri në nëntor të vitit 2017, pa kryer veprime hetimore. Më pas dosja i kaloi prokurores Blerta Hamza, e cila nuk ka pranuar të japë shpjegime.

62.1. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi pretendimet për zvarritjen e hetimeve, e cila në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 ka sqaruar se procedimi penal nr. ***, që i përket denoncuesit është regjistruar në vitin 2015 kur nuk ka qenë në detyrë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe i ka kaluar asaj në datën 15.12.2017. Sipas saj, në datën 26.10.2018 janë mbyllur hetimet paraprake dhe në datën 19.12.2018 kjo çështje është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërkohë që vonesa në përfundimin e hetimeve paraprake ka ardhur si pasojë e zëvendësimit të 3 prokurorëve të mëparshëm dhe në asnjë rast nuk ka pasur zvarritje të qëllimshme, ndërsa vonesat e tjera kanë

⁴²Shihni denoncim nga shtetasi G. T., protokolluar me nr. *** prot., datë 10.8.2018, në Komision.

ardhur si pasojë e heqjes dorë të ekspertëve urbanistikë nga kryerja e ekspertimit dhe koha që është dashur për hartimin e ekspertimit nga e para. Më tej, subjekti ka sqaruar se në mënyrë të ripërsëritur ka sqaruar denoncuesin për vazhdimin e hetimeve. Sipas saj çështja penale është ende në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe denoncuesi i ka të gjitha mundësitë të paraqesë pretendimet e tij.

62.2. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur kopje të akteve të administruara në dosjen e procedimit penal nr. ***, nga të cilat u konstatua se:

- në datën 1.12.2015 është regjistruar nga prokurori S. B., procedimi penal nr. *** për veprën penale “shpërdorimi detyre”;

- me vendimin e datës 11.5.2017 të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, z. G. Sh., është vendosur bashkimi i procedimit penal nr. *** me procedimin penal nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre”, në një procedim të vetëm, atë me nr. ***;

- në datën 702.2018, prokurorja Blerta Hamza ka vendosur ekspertimin teknik të objekteve dhe lejeve nga ekspertët M. F. dhe H. K., duke përcaktuar pyetjet që do t’u drejtohen, i përfunduar në mars të vitit 2018(pa përcaktuar datë); në datën 13.9.2018 është kërkuar nga Bashkia Shkodër dokumentacion; si dhe në datën 14.10.2018 prokurorja Blerta Hamza, ka vendosur këqyrje dokumentacioni pranë ZVRPP-së Shkodër;

- me urdhrin e datës 26.10.2018, prokurorja Blerta Hamza ka urdhëruar të shënohen në regjistrin e procedimeve penale emrat e personave: A. Sh., Gj. L., J. V., S. L., S. Z. dhe I. T.;

- me kërkesën e datës 19.12.2018, subjekti ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. *** në ngarkim të të pandehurve A. Sh., Gj. L. J., V., S. L., S. Z. dhe I. T. për veprën penale të shpërdorimit të detyrës;

- me vendimin nr. ***, datë 13.5.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër vendosi pushimin e çështjes penale nr. ***, për të gjithë të pandehurit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe viktima G. T.. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 29.7.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 13.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për gjykimin e procedimit penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurve A. Sh., Gj. L. J. V., S. L., S. Z. dhe I. T., për veprën penale të shpërdorimit të detyrës;

- në datën 23.12.2020, prokurorja Blerta Hamza është zëvendësuar nga një prokuror tjetër.

62.3. Nga dokumentacioni i administruar u konstatua se procedimi penal nr. ***, është regjistruar në datën 1.12.2015, pa emër personi nën hetim. Hetimet deri në datën e dërgimit për gjykim më 19.12.2018, kanë zgjatur rreth 3 vjet dhe janë ndjekur nga disa prokurorë. Hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për këtë çështje, kanë zgjatur 10 muaj, nga data 15.12.2017 – 26.10.2018 dhe gjatë kësaj periudhe nga ana e saj janë kryer veprime hetimore konkrete. Për sa i takon pretendimit të denoncuesit për mosdhënie sqarimesh nga ana e subjektit, konstatohet se nuk qëndron, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezultojnë dy shkresa kthim përgjigjen me nr. *** prot., datë 28.3.2018 dhe nr. *** prot., datë 14.9.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër drejtuar denoncuesit G. T. në të cilën informohet mbi fazën e procedimit penal.

62.4. Në përfundim, nuk u konstatuan problematika në veprimet e procedurale të kryera nga prokurorja Blerta Hamza, gjatë trajtimit të çështjes objekt shqyrtimi.

63. Denoncuesit N. M. dhe S. M.⁴³ kanë paraqitur përpara Komisionit katër kërkesa. Nga përmbajtja e këtyre denoncimeve, konstatohet se denoncuesit kanë kërkuar pezullimin nga detyra të prokurorëve G. Sh., A. S. dhe Blerta Hamza, bazuar në nenet 151 dhe 152 të ligjit nr. 96/2016, duke qenë se ndaj tyre kishin paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, e cila me vendimin e datës 16.2.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 30.1.2018, me arsyetimin se fakti nuk ekziston. Bashkëlidhur denoncimit, janë paraqitur disa dokumente shkresore, nga analiza e të cilave, rezultoi se pretendimet e denoncuesve në lidhje me prokurorët e sipërpërmendur janë bërë objekt hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në lidhje me veprën penale “korrupsion aktiv/pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprën penale “shpërdorim detyre”. Këto vendimmarrje i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe janë lënë në fuqi: (i) nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e cila me vendimin nr. ***, datë 9.10.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit si të pabazuar; (ii) nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 12.2.2019, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 18.3.2019.

64. Denoncuesi E. H.⁴⁴ ngre pretendime se prokurorja Blerta Hamza ka ngritur një akuzë të padrejtë ndaj tij dhe të pambështetur, pa referuar ndonjë shkelje konkrete apo dokument shkresor. Veç kësaj, ky pretendim lidhet me bindjen e brendshme të prokurorit dhe vlerësimin e provave, të cilat janë jashtë tagrit të vlerësimit nga Komisioni.

65. Denoncuesi Xh. Zh.⁴⁵ nuk referon shkelje të kryera nga prokurorja Blerta Hamzaj.

66. Denonuese L. L.⁴⁶ ngre pretendime për vendimmarrje të padrejtë ndaj një grupi prokurorësh, ndër të cilët edhe Blerta Hamza, duke i kërkuar Komisionit të verifikojë vendimet e dhëna prej tyre, por pa referuar shkelje ligjore konkrete të kryera prej tyre. Veç kësaj, ky pretendim lidhet me vendimmarrjen e disa subjekteve, vlerësimi për të cilët është jashtë tagrit të Komisionit.

67. Gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni është bazuar edhe në informacionin e marrë nga burimet arkivore, nga të dhënat nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, nga ku rezultoi se për subjektin Blerta Hamza:

i) nuk ka pasur masa disiplinore;

ii) ka pesë materiale hetimore të regjistruara në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, si vijojnë: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar Tiranë, ka informuar se: “..... nuk rezulton që në emër të shtetases Blerta Hamza, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Kjo shtetase përmendet si e kallëzuar në kuadrin e procedimit penal nr. ***, vitit 2020, i bashkuar me procedimin penal nr. ***, të vitit 2020, në një procedim të vetëm me nr. ***, të vitit 2020. Ky procedim është në fazën e hetimit dhe nuk ka emër të regjistruar”; si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka informuar se për subjektin e rivlerësimit Blerta Hamza janë regjistruar katër çështje penale që i përkasin vitit

⁴³Shihni denoncim e shtetasit N. M., protokolluar me nr. *** prot., datë 27.6.2018, në Komision; kallëzim penal protokolluar me nr. *** prot., datë 19.1.2018, në Komision; kallëzim penal, protokolluar me nr. *** prot., datë 27.5.2019, në Komision; apelim drejtuar Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, protokolluar me nr. *** prot., datë 23.10.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴⁴Shihni denoncim nga shtetasi E. H., protokolluar me nr. *** prot., datë 18.12.2017, në Komision.

⁴⁵Shihni denoncim nga shtetasi Xh. Zh., përcjellë nga IKP-ja dhe protokolluar me nr. *** prot., datë 4.2.2019, në Komision.

⁴⁶Shihni denoncim nga shtetasja L. L., protokolluar me nr. *** prot., datë 15.2.2019, në Komision.

2018 dhe 2020, për dy nga të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, një është pushuar dhe një tjetër është në fazë hetimi;

iii) ka pasur dy ankesa për periudhën 2006 – 2018, nga Regjistrat e Ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilat janë paraqitur edhe pranë Komisionit, si vijojnë: (i) praktika nr. *** prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit N. dhe S. M., kundër prokurores Blerta Hamza, për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal; dhe (ii) praktika nr. *** prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankimin e shtetasit P. N., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurores Blerta Hamza, për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore, nuk kanë rezultuar problematika dhe elementë që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”.

68. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se: (i) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; (iv) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

69. Në datën 5.7.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Blerta Hamza, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Blerta Hamza dhe shpalli vendimin në datën 7.7. 2021, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

70. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar, duke paraqitur në çdo rast dokumente shkresore për të vërtetuar për sa i është kërkuar nga Komisioni, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Blerta Hamza, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Blerta Hamza, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Firdes SHULI

Relatore

Suela ZHEGU

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi

